



Pranuar më: Primljeno: 15-06. 2021		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-20-32007		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF – NR.02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR EVIDENTIMIN DHE ZHVENDOSJEN E
ASETEVE-INVENTARIT JASHTË PËRDORIMIT

Neni 1

Përbërja e Komisionit

Formohet Komisioni për evidentimin dhe zhvendosjen e asetëve-inventarit jashtë përdorimit, në përbërje si vijon:

1. Rrahim Krasniqi, Kryesues
2. Bestar Ibrahim, anëtar
3. Behar Aliu, anëtar
4. Zymrije Azemi, anëtare

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka për detyrë që të evidentojë dhe zhvendosë inventarin i cili është jashtë përdorimit dhe i cili gjendet në objektin e Komunës dhe barakat që gjenden pas objektit të Komunës .

Komisioni është i obliguar që asetet - inventarin ta evidentojë dhe zhvendosë në vendin e përcaktuar nga Drejtorati i Administratës dhe për gjithë punën e tij të mbajë procesverbal. Detyrat e cekura , Komisioni është i obliguar ti kryej brenda afatit 20 ditor nga dita e pranimit të Vendimit dhe pas përfundimit ti raportoj me shkrim Kryetarit të Komunës, Drejtorit të Drejtoratit për Administratë dhe Zyrtarit për Pasuri .

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë me kopjen e të cilit do të njoftohen, Drejtorati për Administratë, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit dhe Zyrtari për Pasuri.

1Nr. 20-32007
Lipjan, më 15-06.2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

